**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 620/2 Prot.

Rrëshen më, 28 . 02 . 2024

# V E N D I M

**Nr. 14 datë 26. 02. 2024**

**PËR**

**MIRATIMIN, E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE, NGA FONDI I KUSHTËZUAR, PËR BLLOK - NDIHMËN DERI NË 6 %, PËR PERIUDHËN 01 – 31 JANAR 2024", BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 7, i ligjit nr.7/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar, për ndihmën ekonomike", dhe në Vendimin nr. 1, datë 31.01.2024, të këshillit bashkiak Mirditë, kryetari i bashkisë, i propozon këshillit bashkiak Mirditë, projekt-vendimin për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit, të cilat do trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën deri 6 %, pas verifikimit real nga administratorët social, të çdo njësie administrative, muaj **JANAR 2024:**

1. **Përmbledhëse e muajit JANAR 2024, të përfitimit të ndihmës ekonomike, nga fondin e kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në 6%, sipas njësive administrative.**

| Nr. | Bashkia Mirditë / njësitë administrative | Gjithësej numri i familjeve dhe fondi | | Komp.energjisë elektrike 6% | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr. familjeve | Fond EN+Shkollë | 6%+EN+Shkollë |
| | | Nr. Fam. | Fondi 6% | Përfituesëve | Lekë | Lekë |
| 1 | RRËSHEN | 33 | 98 978 | 22+1 | 28 336+300 | 127 614 |
| 2 | OROSH | 10 | 33 322 | 5 | 6 440 | 39 762 |
| 3 | FAN | 11 | 29 912 | 2 | 2 576 | 32 488 |
| 4 | SELITË | 5 | 17 279 | 3 | 3 864 | 21 143 |
| 5 | RUBIK | 20 | 58 191 | 13+1 | 16 744+300 | 75 235 |
| 6 | KTHELLË | 6 | 22 372 | 5 | 6 440 | 28 812 |
| 7 | KAÇINAR | 15 | 38 818 | 2 | 2 576 | 41 394 |
| | **T O T A L** | **100** | **298 872** | **52+2** | **66 976+600** | **366 448** |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë; (agjencia e shërbimeve sociale, arsimit dhe kulturës - sektori ndihmës ekonomike).

*Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**S E K R E T A R**

**Gaspër TOPOLLAJ**

**K R Y E T A R**

**Aleksandër PICAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:keshilli@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 652/2 Prot.

Rrëshen më, 28 . 02 . 2024

# V E N D I M

**Nr. 15 datë 26. 02. 2024**
**PËR**
**MIRATIMIN, E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE, PËR BLLOK – NDIHMËN, ME FONDIN E BASHKISË, PËR PERIUDHËN 01 - 31 JANAR 2024",**
**BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 7, i ligjit nr.7/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar, për ndihmën ekonomike", dhe në Vendimin nr. 1, datë 31.01.2024, të këshillit bashkiak, kryetari i bashkisë, i propozon këshillit bashkiak Mirditë, projekt-vendimin për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit, të cilat do trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën, me fondin e bashkisë, pas verifikimit real nga administratorët social, të çdo njësie administrative, - **JANAR 2024:**

1. **Përmbledhëse e muajit JANAR 2024, të përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën, me fondin e bashkisë sipas njësive administrative.**

| Nr. | Bashkia Mirditë / njësitë administrative | Gjithësej numri i familjeve dhe fondi | | Komp.energjisë elektrike | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr. familjeve | Fond EN+Shkollë | EN+Shkollë |
| | | Nr. Fam. | Fondi | Përfituesëve | Lekë | Lekë |
| 1 | RRËSHEN | 24 | 98 847 | 14 | 18 032 | 116 879 |
| 2 | OROSH | 2 | 6 317 | 2 | 2 576 | 8 893 |
| 3 | FAN | 2 | 16 344 | 2 | 2 576 | 18 920 |
| 4 | SELITË | 6 | 32 228 | 1 | 1 288 | 33 516 |
| 5 | RUBIK | 6 | 28 588 | 4 | 5 152 | 34 740 |
| 6 | KTHELLË | 4 | 28 568 | 4 | 5 152 | 33 720 |
| 7 | KAÇINAR | 3 | 18 508 | 1 | 1 288 | 19 796 |
| | **T O T A L** | **47** | **230 400** | **28** | **36 064** | **266 464** |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë; (agjencia e shërbimeve sociale, arsimit dhe kulturës - sektori ndihmës ekonomike).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**S E K R E T A R**
**Gaspër TOPOLLAJ**

**K R Y E T A R**
**Aleksandër PICAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:keshilli@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 563/1 Prot.

Rrëshen më, 28. 02. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 16 datë 26. 02. 2024**

**PËR**
**"TRAJTIM ME BURSË SHTETI PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME DHE TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL, VITI I-rë, (JASHTË RRETHIT), PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024", BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, VKM nr. 666 datë 10.10.2019 *"Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike"* i ndryshuar, pika 9, e cila përcakton *"Bursat e nxënësve për vitin e parë (klasën e 10) shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak, sipas vendbanimit të përhershëm të prindit/nxënësit"*, në shkresën nr. 4072 prot datë 01.11.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2023-2024"*, për Bashkinë Mirditë janë miratuar **5 bursa**, në shkresën nr. 4409 prot. datë 22.11.2023, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit *"Për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2023-2024"*, për bashkinë Mirditë janë miratuar **19 bursa**, në P/vendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë (agjencia e shërbimeve sociale, arsimit dhe kulturës), për trajtimin me bursë nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm dhe profesional, ***viti i parë***, për vitin shkollor 2023-2024, këshilli bashkiak pas diskutimeve;

**V E N D O S I:**

A. Të miratojë për trajtim me bursë shteti të plotë (100 %) për nxënësit e shkollave të mesme profesionale, ***viti i parë*** (jashtë rrethit) për vitin shkollor 2023-2024 si vijon;

1. **Kleart Kastriot GJIKOLAJ** banore në Kurbnesh, njësia administrative Selitë, nxënëse në shkollën e mesme profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë, në degën Teknologji Ushqimore.

B. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (agjencia e shërbimeve aociale, arsimit dhe kulturës).

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**S E K R E T A R**
**Gaspër TOPOLLAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

**K R Y E T A R**
**Aleksandër PICAKU**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 653/2 Prot.

Rrëshen, më 28.02.2024

# V E N D I M

## Nr. 17 datë 26. 02. 2024

## "MBI SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË SHOQËRIVE "ONE ALBANIA" SHA, DHE "VODAFONE ALBANIA" SHA, PËR AMENDIM / RINOVIM DHE PRISHJE TË NJËANËSHME TË KONTRATAVE ME BASHKINË MIRDITË.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 54/e, ligjin nr. 57, datë 30.04.2020, "Për pyjet", kreu i III-të, neni 15, ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor, shoqërive "One Albania" sha, dhe "Vodafone Albania" sha," të ndryshuar, VKM nr.684, datë 02.09.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave /Bashkive" të ndryshuar, VKM-në nr. 632, datë 12.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje bari", VKM- nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave ",Udhëzimin nr.1.datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik ", kërkesa e subjekteve "One Albania" sha, dhe "Vodafone Albania" sha, këshilli i bashkiak, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë:

## V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së subjektit; "One Albania" sha, (site Repsi – 1088), me nr.1531, prot, datë 24.11.2023, e administruar në bashki me nr. 4549, prot, datë 05.12.2023, për rinovim dhe amendim të Kontratës me nr. 4443, prot, datë 11.10.2018.

1.1- Vlera e qirasë vjetore është 209 400 (dyqind e nëntë mijë e katërqind) lekë.

1.2- Afati i dhënies me qira është 6 (gjashtë) vjeçar, me të drejtë rinovimi.

1.3- Amendim të kësaj kontrate, duke shtuar një paragraf me këtë përmbajtje; "*Palët bien dakort që Qiramarrësi ka të drejtë ta kalojë apo transferojë këtë kontratë dhe të gjitha të drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj tek një përson apo entitet tjetër pjesërisht apo të tërën, kundrejt një njoftimi paraprak me shkrim prej 15 ditë përpara dhe vetem pas miratimit me shkrim nga ana e bashkisë Mirditë*".

2. Miratimin e kërkesws të subjektit; "One Albania" sha, (site KK 2008 ), me nr. 1532 prot, datë 24.11.2023, e administruar në bashki me nr. 4549/1, prot, datë 05.12.2023: për rinovim dhe amendim te Kontrata me nr.1152, prot, datë 13.03.2019.

2.1- Vlera e qirasë vjetore është 55 900 (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) lekë.

2.2- Afati i dhënies me qira është 6 (gjashtë) vjeçar, me të drejtë rinovimi.

**2.3**- Amendim të kësaj kontrate, duke shtuar një paragraf me këtë përmbajtje; "*Palët bien dakort që Qiramarrësi ka të drejtë ta kaloj apo transferoj këtë kontratë dhe të gjitha të drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj tek një përson apo entitet tjetër pjesërisht apo të tërën, kundrejt një njoftimi paraprak me shkrim prej 15 ditë përpara dhe vetem pas miratimit me shkrim nga ana e bashkisë Mirditë*".

3. Miratimin e kërkesës të subjektit; "One Albania" sha, (site Kaçinari 1308 ), nr.1533 prot, datë 24.11.2023, e administruar në bashki me nr. 4549/2 prot, datë 05.12.2023, për amendim të Kontratës me nr. 1533 prot, datë 24.11.2023, duke shtuar paragrafin me këtë përmbajtje: "*Palët bien dakort që Qiramarrësi ka të drejtë ta kaloj apo transferoj këtë kontratë dhe të gjitha të drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj tek një përson apo entitet tjetër pjesërisht apo të tërën, kundrejt një njoftimi paraprak me shkrim prej 15 ditë përpara dhe vetem pas miratimit me shkrim nga ana e bashkisë Mirditë*".

4. Miratimin e kërkesës të subjektit; "One Albania" sha, me nr. 1534 prot, datë 24.11.2023, e administruar në bashki me nr. 4549/3 prot, datë 05.12.2023, për rinovim dhe amendim të Kontratës me nr.1154 prot, datë 13.03.2019.

**4.1**- Vlera e qirasë vjetore është 335 000 ( treqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.

**4.2**- Afati i dhënies me qira është 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rinovimi.

**4.3**- Amendim të kësaj kontrate, duke shtuar një paragraf me këtë përmbajtje; "*Palët bien dakort që Qiramarrësi ka të drejtë ta kaloj apo transferoj këtë kontratë dhe të gjitha të drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj tek një përson apo entitet tjetër pjesërisht apo të tërën, kundrejt një njoftimi paraprak me shkrim prej 15 ditë përpara dhe vetem pas miratimit me shkrim nga ana e bashkisë Mirditë*".

5. Miratimin e kërkesës të subjektit; "One Albania" sha, (site KU - 0007), me nr. 1564 prot, datë 30.11.2023, e administruar në bashki me nr. 4549/4 prot, datë 05.12.2023, Kërkësë për zgjidhje të njëanëshme të kontratës me nr. 425 prot, datë 27.01.2021, me afat deri me 31.12. 2025.

**5.1**- Zgjidhja e kontratës realizohet, pasi kërkuesi të ketë shlyer të gjitha detyrimet kontraktore me qiradhwnësin, si dhe Kthimin në gjendjen e mëparëshme të siperfaqes prej 0.02 ha, nga truall në sipërfaqe të gjelbërt, nëpërmjet rehabilitimit me pyllëzim.

6. Miratimin e kërkesës të subjektit; "Vodafone Albania" sha (site 477), me ref; prop/053/rr, datë 20.12.2003, e administruar në bashki me nr. 276 prot, datë 22.01.2024, me objekt për rinovim kontratës me nr. 4477 prot, datë 10.10.2017.

**6.1**- Vlera e qirasë vjetore është 328 000 ( tre qind e njëzet e tetë mijë) lekë.

**6.2**- Afati i dhënies me qira është 6 (gjashtë) vjeçar, me të drejtë rinovimi.

7. Miratimin e kërkesws të subjektit " Vodafone Albania" sha, (site 619 Rrëshen ), me ref; prot/053/rr, datë 20.12.2003, administruar në bashki me nr. 276, prot, datë 22.01.2024, me objekt për rinovim kontratës me nr. 2002, prot, datë 08.05.2019.

**7.1**- Vlera e qirasë vjetore është 500 000 ( pesë qind mijë) lekë.

**7.2**- Afati i dhënies me qira është 6 (gjashtë) vjeçar, me të drejtë rinovimi.

8. Miratimin e kërkesës të subjektit; "Vodafone Albania" sha, (site 541 Shpal), me ref; prop/053/rr, datë 20.12.2003, e administruar në bashki me nr. 276 prot, datë 22.01.2024, me objekt për rinovim kontratës me nr. 2001 prot, datë 08.05.2019.

8.1- Vlera e qirasë vjetore është 258 000 ( dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë.
8.2- Afati i dhënies me qira është 6 (gjashtë) vjeçar me të drejtë rinovimi.

9. Miratimin e kërkesës të subjektit; "Vodafone Albania" sha, (site 416 Kacinari), me ref; prop/053/rr, datë 20.12.2003, e administruar në bashki me nr. 276 prot, datë 22.01.2024, me objekt për rinovim kontratës me nr. 4478 prot, datë 10.10.2017.

9.1- Vlera e qirasë vjetore është 275 000 ( dy qind e shtatëdhjtë e pësë mijë) lekë.
9.2- Afati i dhënies me qira është 6 (gjashtë) vjeçar, me të drejtë rinovimi.

10. Relacioni nr. 653 prot, datë 14.02.2024, "Mbi shqyrtimin e kërkesave të shoqërive, "One Albania" sha dhe "Vodafone Albania" sha, për amendim/rinovim, dhe zgjidhje të njëanëshme të kontratatave me bashkinë Mirditë, bashkëlidhur pjesë përbërse e këtij vendimi.

11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, (agjencia e shërbimit bujqësor, veterinar dhe pyjor dhe drejtoria juridike).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

**KRYETAR**

**Aleksandër PICAKU**

**BASHKIA MIRDITË**

**Nr. 653 Prot.**

**Rrëshen më 14.02.2024**

# R E L A C I O N

**Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK**

## MBI SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË SHOQËRIVE " ONE ALBANIA " sha, DHE " VODAFONE ALBANIA " Sha, PËR AMENDIM / RINOVIM DHE PRISHJE TË NJËANNËSHME TË KONTRATAVE ME BASHKINË MIRDITË.

*(Qiramarrës trualli dhe rrugë lidhëse për Vendosje të antenave të telefonisë celulare në fondin pyjor/kullosor, pronë e bashkisë)*

Bazuar në " Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, date 29.07.2022 " Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe te kullotave ", e kërkesave të subjekteve One Albania Sh **a.** dhe Vodafone Albania Sha, grupi i punës i përbër nga; Përgjegjësja e sektorit pyjor Ing. Eneida Nikolli, specialistët Ing. Gjovalin Nikolli dhe Ing. Preng Nikolli, pasi administroi shqyrtoi kërkesat e shoqërisë **" One Albania " Sha**, dhe **" Vodafone Albania " Sha** realizoi verifikimin e dokumentacionit, dhe verifikimin në terren të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku shtrihen vend ndodhjet e tyre, dhe në përfundim konkludoi ;

**I-One Albania Sh a.**

1.Kërkesa e shoqërisë **" One Albania " Sha, (site Repsi – 1088 ), me *nr.1531, prot datë 24.11.2023 e administruar në bashki me nr. 4549 prot, datë 05.12.2023*,** me objekt " Kërkëse për rinovim kontrate qiraje "; kontrata me nr.4443 prot, datë 11.10.2018, e cila përfundon me 02.01.2024, kërkon ta rinovoj me të njejtat kushte për një afat 6 – vjeçar, nga 02.01.2024 – 01.01.2030, dhe të amendohet, duke shtuar paragrafin; **" Palët bien dakort që Qiramarrësi ka të drejtë ta kaloj apo transferoj këtë kontratë dhe të gjitha të drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj tek një përson apo entitet tjetër pjesërisht apo të tërën, kundrejt një njoftimi paraprak me *shkrim prej 15 ditë përpara dhe vetëm pas miratimit me shkrim nga ana e bashkisë Mirditë* ".** Duke qenë se kategoria dhe sipërfaqja që qiramarrësi ka në përdorim në fondin pyjor, sipërfaqja prej 0.02 ha, në n/ngastrën 57/a të Lugina e Fanit Madh; dhe 0.98 km, rrugë lidhëse, në n/ngastrën 52/b, 51/a,b të Lugina e Fanit Vogël nuk ndryshon; si dhe tarifat për njësi, sipas VKM - së Nr. 559, datë 29.7.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në

shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", shtojca 1, pika 7, 11, nuk kanë ndryshuar, në këto rrethana;

**Kontrata me nr.4443 prot, datë 11.10.2018: Të rinovohet dhe amendohet me subjektin, " One Albania " Sha, me një tarifë totale 209 400 ( dyqind e nëntë mijë e katërqind) lekë "**, e ndarë në;

-Tarifë trualli, 0.02ha x 8 000 000 lekë/ha = 160 000 leke/vit

-Tarifë rrugë lidhëse, 0.5 km x 70 000 lekë/km = 35 000 lekë/vit dhe 0.48 km x 30 000 lekë/km = 14 400 lekë/vit, gjithësej rrugën lidhëse 49 400 lekë/vit.

2. Kërkesa e shoqërisë " **One Albania " Sha. (site KK 2008 ), nr.1532 prot, datë 24.11.2023 e administruar në bashki me nr. 4549/1 prot, datë 05.12.2023**, me objekt " Kërkese për amendimin e kontratës së qirasë ", kontrata me nr.1152 prot, datë 13.03.2019, me afat deri me 1.09.2027, kërkon ta amendojë me të njëjtat kushte, duke shtuar paragrafin; " **Palët bien dakort që Qiramarrësi ka të drejtë ta kaloj apo tranferoj këtë kontratë dhe të gjitha të drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj tek një person apo entet tjetër pjesërisht apo të tërën, kundrejt një njoftimi paraprak me shkrim prej 15 ditë përpara *dhe vetëm pas miratimit me shkrim nga ana e bashkisë Mirditë* ".** Duke qenë se sipërfaqja që qiramarrësi ka në përdorim në fondin pyjor nuk ndryshon; sipërfaqja prej 0.0061 ha, dhe 0.142 km, rrugë lidhëse në n/ngastrën nr.48 të ekonomisë pyjore Domgjon, që janë në pronësi të Qiradhënësit; Bashkia Mirditë, nuk ndryshojnë; si dhe bazuar në VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca 1, pika 7, 11, nuk kanë ndryshuar;

**Kontrata me nr.1152 prot, datë 13.03.2019; Të amendohet me subjektin, " One Albania " Sh a, me një tarifë totale 55 900 ( pesë dhjetë e pesë mijë e nëntë qind) lekë** e ndarë në;

-Tarifë trualli, 0.0061ha x 8 000 000 lekë/ha = 48 800 leke/vit

-Tarifë rrugë lidhëse, 0.142 km x 50 000 lekë/km = 7 100 leke/vit.

3. Kërkesa e shoqërisë " **One Albania " Sha. (site Kaçinari 1308 ), nr.1533 prot, datë 24.11.2023 e administruar në bashki me nr. 4549/2 prot, datë 05.12.2023**, me objekt " Kërkese për amendimin e kontratës së qirasë ", kontrata me nr.1951 prot, datë 17.05.2021, me afat 5.02.2021 deri me 4.02. 2030, kërkon ta amendojë me të njejtat kushte, duke shtuar paragrafin; **" Palët bien dakort që Qiramarrësi ka të drejtë ta kaloj apo tranferoi këtë kontratë dhe të gjitha të drejtat , detyrimet apo angazhimet e saj tek një përson apo entitet tjetër pjesërisht apo të tërën, kundrejt një njoftimi paraprak me shkrim prej 15 ditë përpara *dhe vetëm pas miratimit me shkrim nga ana e bashkisë Mirditë* ".** Duke qenë se sipërfaqja që qiramarrësi ka në përdorim në fondin pyjor nuk ndryshon; sipërfaqja prej 0.03 ha, dhe 0.5 km, rrugë lidhëse në n/ngastrën nr. 81, ekonomia pyjore Qaf Mollë, që është në pronësi të Qiradhënësit; bashkia Mirditë, nuk ndryshojnë; si dhe bazuar në VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", shtojca 1, pika 7, 11, nuk kanë ndryshuar;

**Kontrata me nr.1951 prot, datë 17.05.2021; Të amendohet me subjektin " One Albania " Sha, me një tarifë totale 335 000 ( treqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë**, e ndarë në;

-Tarifë trualli, 0.03 ha x 10 000 000 lekë/ha = 300 000 leke/vit.

-Tarifë rrugë lidhëse, 0.5 x 70 000 lekë/km = 35 000 leke/vit.

4. Kërkesa e shoqërisë " **One Albania " Sha. (site KK 2009 ), nr. 1534 prot, datë 24.11.2023 e administruar në bashki me nr. 4549/3 prot, datë 05.12.2023**, me objekt " kKrkëse për amendimin e kontratës së nr.1154 prot, datë 13.03.2019, me afat deri më 28.10 2027, kërkon ta amendojë me të njejtat kushte, duke shtuar paragrafin; " **Palët bien dakort që Qiramarrësi ka të drejtë ta kaloj apo tranferoi këtë kontratë dhe të gjitha të drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj tek një person apo entitet tjetër pjesërisht apo të tërën, kundrejt një njoftimi paraprak me shkrim prej 15 ditë përpara *dhe vetëm pas miratimit ma shkrim nga ana e bashkisë Mirditë*** ". Në këto rrethana përderisa një kërkesë e tillë nuk bie ndesh me dispozitat në fuqi, Duke qenë se sipërfaqja që qiramarrësi ka në përdorim në fondin pyjor nuk ndryshon; sipërfaqja prej 0.0125 ha, dhe 0.216km, rrugë lidhëse në n/ngastrën nr. 11/b të ekonomisë pyjore Shkallgjanë, që janë në pronësi të Qiradhënësit; Bashkia Mirditë nuk ndryshojnë; si dhe bazuar në VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", shtojca 1, pika 7, 11, nuk kanë ndryshuar ;

**Kontrata me nr.1154 prot, datë 13.03.2019; Të amendohet me subjektin " One Albania " sh a, me një tarifë totale 140 120 ( njëqind e dyzet mijë e njëqind e njëzet) lekë**, e ndarë në;

-Tarifë trualli, 0.0125ha x 10 000 000 lekë/ha = 125 000 leke/vit.

-Tarifë rrugë lidhëse, 0.216 x 70 000 lekë/km = 15 120 lek/vit.

5. Kërkesa e shoqërisë " **One Albania " Sh a. (site KU - 0007), nr. 1564 prot, datë 30.11.2023 e administruar në bashki me nr. 4549/4 prot, datë 05.12.2023**, me objekt "Kërkëse për përfundimin e kontratës ", kontrata me nr.425 prot, datë 27.01.2021, me afat deri me 31.12. 2025, kërkon të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme në fondin pyjor ekonomia pyjore Luginat e Rrubikut.

Bazuar në kontatën e mësipërme neni 11, pika 1/IV, pasi të verifikohen detyrimet financiare, të bëhet marrveshja për kthimi i sipërfaqeve në gjendjen e mëparëshme nëpërmjet rehabilitimit me ripyllëzim sipas parashkimeve në projektin e miratuar të rehabilitimit.

Sipas përllogaritjeve kostoja mesatare e rehabilitimit të sipërfqes me pyllëzime/ripyllëzime, sipas VKM. Nr. 537, datë 22.09.2021, " Për përcaktimin e kostos për pyllëzime kompensuese " (për pyllëzime për 1 ha në skemën 2 x 2 m), rezulton të jetë;

0.02 ha x 899 220 lek/ha = 17 985 (shtatëmbëdhjet mijë e nënteqind e tetëdhjetë e pesë) leke.

**II-Vodafone Albania Sha.**

1.Kërkesa e shoqërisë " **Vodafone Albania Sh.a " (site 477 ), me ref; prop/053/rr, datë 20.12.2003, e administruar në bashki me nr. 276 prot, datë 22.01.2024** , me objekt " Kërkësë për rinovim kontrate qiraje "; kontrata me nr. 4477 prot, datë 10.10.2017, e cila ka përfunduar me 11.03.2023, kërkon ta rinovojë me të njejtat kushte sipas nenit 4.1.1 " Afati i kontratës mbaron me datë 11.03.2023, dhe sipas nenit 4.2, të kontratës palët mund të merren vesh për zgjatjen / rinovimin e afatit të kësaj kontrate, duke njoftuar me shkrim palën tjetër

përpara përfundimit të saj" për një afat 9 – vjeçarë, nga 12.03.2023 – 11.03.2032. Duke qenë se kategoria dhe sipërfaqja që qiramarrësi ka në përdorim në fondin pyjor, sipërfaqja prej 0.03 ha, në n/ngastrat 102, ekonomia pyjore bjeshkët e oroshit, dhe 0.4 km, rrugë lidhëse, nuk ndryshon; si dhe tarifat për njësi, sipas VKM - së Nr. 559, datë 29.7.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca 1, pika 7, 11, nuk kanë ndryshuar, në këto rrethana;
**Kontrata me nr. 4477 prot, datë 10.10.2017; Të rinovohet me subjektin,** "Vodafonë Albania Sh.a, **" me një tarifë totale 328 000 ( tre qind e njëzet e ttetë mijë) lekë "**, e ndarë në;

-Tarifë trualli, 0.03ha x 10 000 000 lekë/ha = 300 000 leke/vit
-Tarifë rrugë lidhëse, 0.4 km x 70 000 lekë/km = 28 000 lek/vit.

**2. Kërkesa e shoqërisë "** Vodafonë Albania Sh. A. **" (site 619 Rrëshen ), me ref; prop/053/rr, datë 20.12.2003, e administruar në bashki me nr. 276 prot, datë 22.01.2024** , me objekt " Kërkëse për rinovim kontrate qiraje " ; kontrata me nr. 2002 prot, datë 08.05.2019, e cila ka përfunduar me 14.10.2023, kërkon ta rinovojë me të njejtat kushte sipas nenit 3,3.1,3.2,3.3,4.1,4.2, " Afati i kontratës mbaron me datë 14.10.2023, dhe sipas nenit 4.2 të kontratës palët mund të merren vesh për zgjatjen / rinovimin e afatit të kësaj kontrate, duke njoftuar me shkrim palën tjetër përpara përfundimit të saj" për një afat 9 – vjeçarë, nga 15.10.2023 – 13.10.2032. Duke qenë se kategoria dhe sipërfaqja e objektit që qiramarrësi ka në pronësi, prej 20 m2 (tarracë) ish bashkia e vjetër nuk ka ndryshuar, në këto rrethana;
**Kontrata me nr. 2002 prot, datë 08.05.2019; Të rinovohet me subjektin, " Vodafonë Albania " Sh.a, " me një tarifë totale 500 000 ( pesë qind mijë) lekë/vitë ".**

**3. Kërkesa e shoqërisë "** Vodafonë Albania " Sha **(site 541 Shpal ), me ref; prop/053/rr, datë 20.12.2003, e administruar në bashki me nr. 276 prot, datë 22.01.2024** , me objekt " Kërkëse për rinovim kontrate qiraje"; kontrata me nr. 2001 prot, datë 08.05.2019, e cila ka përfunduar me 21.09.2023, kërkon ta rinovojë me të njejtat kushte sipas nenit 4.1.1 " Afati i kontratës mbaron me datë 21.09.2023, dhe sipas nenit 4.2 të kontratës palët mund të merren vesh për zgjatjen / rinovimin e afatit të kësaj kontrate, duke njoftuar me shkrim palën tjetër përpara përfundimit të saj" për një afat 9 – vjeçarë, nga 22.09.2023 – 21.09.2032. Duke qenë se kategoria dhe sipërfaqja që qiramarrësi ka në përdorim në fondin pyjor, sipërfaqja prej 0.03 ha, në n/ngastra nr.57a, të ekonomisë pyjore Lugina e Fanit të Madhë, dhe 0.4 km, rrugë lidhëse, n/ngastra nr. 51b dhe 52ab, EP.Lugina e Fanit Vogël, nuk ndryshon; si dhe tarifat për njësi, sipas VKM - së Nr. 559, datë 29.7.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca 1, pika 7, 11, nuk kanë ndryshuar, në këto rrethana; ( nga gjeoreferimi i ri i hartave kdastrale nga Datek, kanë ndryshur nr. e n/ngastrave, trualli është në n/ngastrën 57/a ekonomia pyjore LFM. Rruga lidhëse prej 0.4 km, në n/ngastrën 52/b, 51/ a,b. LFM.).
**Kontrata me nr. 2001 prot, datë 08.05.2019; Të rinovohet me subjektin, " Vodafonë Albania Sh.a, " me një tarifë totale 258 000 ( dy qind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë "**, e ndarë në;

-Tarifë trualli, 0.03ha x 8 000 000 lekë/ha = 240 000 leke/vit

-Tarifë rrugë lidhëse, 0.4 km x 70 000 lekë/km = 18 000 lek/vit.

